



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr. ____ .Prot.

Peqin, më ____/12/2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, Datë ____.12.2023

“MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, NËPUNËSVE CIVILË DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË PEQIN DHE TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË PEQIN”

Mbështetur në shkronjën ç) dhe dh) të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore“ Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Peqin;

Propozim:

1. Të miratojë numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Peqin.
2. Numri maksimal i punonjësve të Bashkisë Peqin detajohet si më poshte vijon:

a) Punonjës të aparatit administrativ, të agjencive dhe institucioneve në vartësi të Bashkisë Peqin;	Gjithsej 231 (dyqind e tridhjetë e një)
b) Gjëndja Civile	“ 5 (pesë)
c) SHMZSH	“ 14 (katërbëdhjetë)
ç) Arsimi parashkollor	“ 60 (gjashtëdhjetë)
d) Bordi Kullimit dhe Shërbimi Pyjor	“ 4 (katër)
3. Të miratojë strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e Bashkisë Peqin sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur dhe pjesë e këtij projekt-vendimi.
4. Të miratojë nivelin e shperblimit të keshilltareve, administratorëve të lagjeve dhe kryetareve të fshatrave në masën 10 % të pagës mujore të kryetarit të bashkisë dhe administratorëve të njësive administrative.
5. Ngarkohet aparati i Bashkisë Peqin për të identifikuar dhe propozuar ndryshimin e të gjitha vendimeve të këshillit të bashkisë, për efekt të ndryshimeve që sjell ky projekt-vendim.
6. Ky projekt-vendim i shtrin efektin financiar duke filluar nga data 01.01.2024.
7. Ngarkohet me zbatimin e këtij projekt-vendimi Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës.

SEKRETARI I PËRGJITHSHM

KRYETARI I BASHKISË

/ **Gentian CANI** /

/ **Bukurosh MAÇI** /